



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 10.11.2025, në ora 16.30, në Dëgjuesën Publike të zhvilluar me qytetarët dhe grupet e interesit, lidhur me Projektbuxhetin Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin Vjetor 2026 dhe Paketën Fiskale për vitin 2026, Faza Përfundimatare.

Dëgjesa Publike bëhet me banorët dhe grupet e interesit të Njësive Administrative Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet dhe Ungrej.

Numri i pjesëmarrësve gjithsej është 86 veta, nga këto: 10 vajza/gra.

Pjesëmarrës nga Bashkia :

1. Pjerin Ndreu me detyrë Kryetar i Bashkisë
 2. Brikena Vuksani me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 3. Eueda Molla me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 4. Fatjon Zefi me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 5. Ndue Luli me detyrë Kryetar i Këshillit të Bashkisë
 6. Redon Gjeloshi me detyrë Administrator i Njesisë Balldre
 7. Pjetër Gjini me detyrë Administrator i Njesisë Blinisht
 8. Gent Marku me detyrë Administrator i Njesisë Dajç
 9. Aldo Marku me detyrë Administrator i Njesisë Kallmet
 10. Agustin Zefi me detyrë Administrator i Njesisë Ungrej
- si dhe anëtarët e tjerë të Grupit Menaxhimit Strategjik.

Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë z.Pjerin Ndreu, ku :

◆ Shpjegoi qëllimin e kësaj dëgjese publike.

◆ Prezantoi Projektprogramin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin dhe Paketën Fiskale për vitin 2026, e në veçanti projektet e investimeve që do të zbatohen, shërbimet që do të kryhen dhe nivelin e taksave dhe tarifave që do të aplikohen.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan, dhanë këto mendime dhe propozime:

Z.Kol Sollaku, fshati Blinisht dha këtë mendim dhe propozim:

1-Çfarë është parashikuar në Buxhetin e vitit 2026, për fshatin Blinisht. Kërkojmë të bëhet rruga e varrezave të fshatit Blinisht.

2-Problem kemi cilësinë dhe çmimin e ujit të pijshëm.

Përgjigje: Do rishikohet kërkesa juaj për rrugën për t'u përfshirë në Buxhetin e vitit 2026. Çmimi i ujit është kompetencë e ERRU^{se}. Ndërsa për cilësinë e ujit të pijshëm do të bashkërendojmë

punën tone me Drejtorinë e sh.a Ujësjellës Kanalizimeve Lezhë, për përmirësimin e situatës.

Z.Zef Ndoj, fshati Balldre, dha këtë mendim apo propozim:

1-Çfarë është menduar për infrastrukturën e fshatit Balldre i Vjetër, në vecanti për lagjen Rrëzë Mali. 2-Kërkojmë rrugë dhe furnizim me ujë të pijshëm për 38 familjeve të kësaj lagjeje.

Përgjigje: Rruga do bëhet, furnizimi me ujë të pijshëm do ta mundësojmë ne si bashki me fondet tona, duke realizuar projektin e furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj lagjeje.

Z.Viktor Sallaku, fshati Blinisht dha këtë mendim apo propozim:

1-Kërkojmë të rikualifikohet Qendra e fshatit Blinisht.

Përgjigje: Po bëhet studimi dhe po përgatitet projekti për rikualifikimin e të gjitha qendrave të Njësi Administrative, ku do të përfshihen sistemimi i rrugëve dhe trotuare, si dhe ndriçimi i këtyre qendrave.

Z.Aleksandër Preka, fshati Gjadër, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kërkojmë të ndërhyhet në 2 akse rrugësh në lagje dhe të rikualifikohet sistemi i ndriçimit të qendres së fshatit Gjadër.

Përgjigje: Do ndërhyjmë me sistemim e 2 rrugëve dhe riparimin e defekteve në sistemin e ndriçimit.

Z.Agustin Koleci, fshati Fishtë, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kërkojmë të zgjatet orari i furnizimit me ujë të pijshëm, sot fshati furnizohet me 1-2 orë ujë në ditë.

Përgjigje: Do bashkëpunoj me shoqërinë aksionere UK Lezhë për t'ju mundësuar zgjatje e orarit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Z.Rrol Marku, fshati Piraj, dha këtë mendim apo propozim:

1-Problem kemi me ujin vaditës në fshati Piraj.

2-Të shtohet më shumë presioni në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Përgjigje: Do punojmë në përmirësimin e gjendjes të sistemit vaditës . Do forcohet më shumë puna në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Z.Gjeto Maçi, fshati Kakarriq, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kemi probleme me pronat e zëna nga ndërtimi i Kampit të Gjadrit. S'kemi marrë dëmshpërblimin.

Përgjigje: Bëj kërkesë me shkrim që të verifikoj problemin dhe do t'ju mundësojmë zgjidhjen e duhur. Prona është në proces regjistrimi në ASHK.

Mbajtësi i procesverbalit

Xhemal Haxhia



Sekretari i GMS-së
Mariolina Lleshi



Kordinatori i GMS-së
Brikena Vuksani































